



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**NR. 249 VENDIMI**

**Tiranë, më 06.03.2020**

**VENDIM**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Etleđa Çiftja</b>	Anëtare
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Relator

Të asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore Anisa Duka, pas shortimit të shpërndarjes së çështjes dhe caktimit të kryesuesit, më datë 16.01.2020, ora 14:00, në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, më datë 06.03.2020, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**Z. Piro Samara - Inspektor pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë**

**BAZA LIGJORE :** Neni 179/b, pika 3, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative;  
Neni 14 e 57 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
Neni 64, germa c) e ligjit nr. 96/2016.

**RRETHANAT E ÇËSHTJES:**

Subjekti i rivlerësimit, **Z. Piro Samara**, ka ushtruar funksionin e Inspektorit pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.10.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është deklaruar mospatja e statusit të magjistratit për z. Piro Samara.

**ARSYET PËR NDËRPRERJEN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

- i. Neni 179/b i Kushtetutës parashikon se procesit të rivlerësimit i nënshtrohen *ex officio* të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, prokurorët, këshillëtarët, kryeinspektorin dhe inspektorët e KLD-së;
- ii. Neni 64, pika c) e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se një nga arsyet për mbarimin e statusit të gjyqtarit është mbushja e moshës për pension;

- iii. Dispozitat kalimtare, neni 160, germa ë) e ligjit nr. 96/2016 parashikon se një nga kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është vërtetimi i ndërprerjes së emërimit, në rast dorëheqjeje dhe arritjes së moshës së pensionit, ku për analogji si shkak konsiderohet edhe mospatja apo humbja e statusit të magjistratit;
- iv. Për sa më lart, Komisioni konstaton se nga momenti që z. Piro Samara nuk ka statusin e magjistratit nuk mund të jetë një nga subjektet e rivlerësimit, që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*;
- v. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se objekti dhe qëllimi për të cilin synon procedura e rivlerësimit është bërë i pamundur. Ligji nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 4, parashikon se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës osë të këtij ligji.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenet 14 e 57 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenin 64, germa c) e ligjit nr. 96/2016,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për z. Piro Samara, me funksion Inspektor pranë ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të nisë ose duhet të konsiderohet i pushuar.
2. Ky vendim u njoftohet z. Piro Samara, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë.
3. Ankimi kundër këtij vendimi bëhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga z. Piro Samara dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela Qirko**  
Kryesuese

**Etleda Çiftja**  
Anëtare

**Lulzim Hamitaj**  
Relator

**Anisa Duka**  
Sekretare gjyqësore